



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr. 173, datë 25.05.2021

**PËR CAKTIMIN ME SHORT TË RELATORIT PËR FILLIMIN E PROCEDURËS
SË NGRITJES NË DETYRËN E DREJTUESIT PËR KANDIDATIN QË KA
KALUAR PROCESIN E VERIFIKIMIT**

Bazuar në nenet 159 pika 2 germa “i”, 164 pika 8, 166 pika 2, 189 pika 1, germa “ç”, 190 të Ligjit nr. 115/2016, “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”, i ndryshuar, në nenin 52 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nenin 19 pika 1 e Rregullores “Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë në pozicionin e drejtuesit në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm” miratuar me Vendimin nr.200, datë 23.09.2020 të Këshillit të Lartë të Prokurorisë,

V E N D O S I:

1. Caktimin me short të relatorit për procedurën e ngritjes në detyrën e drejtuesit për kandidatin që ka kandiduar për vendin vakant të drejtuesit në prokurorinë e juridiksionit të përgjithshëm, si më poshtë:

- Pozicion vakant i Drejtuesit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tropojë, relator Vatë Staka.

2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit.

